



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 94 dt. 27.10.2014

Në mbështetje të nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “ Sheshi Lord Bajron” Tepelenë me sugjerimet:

- *Eliminimin e tualeteve publike nga strukturat e kalasë dhe të shkallëve.*
- *Rehabilitimin e këtyre hapësirave pas prishjes së tualeteve.*
- *Prishjen e murit pranë murit të kalasë.*
- *Uljen e lartësisë së murit pranë shkallareve deri në nivelin natyral të terrenit.*
- *Ndriçimi për muret e kalasë të jetë i zhytur në bar.*
- *Reduktimi i gjelbërimit të lartë në sheshin përpara kalasë.*

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI